



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr.178/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: NNP “WENDA”-Vushtrri, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “NP Konaku”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën e Busisë” me nr. të prok: “616-19-9179-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë, më datën: 16.04.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit NNP “WENDA”-Vushtrri, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën e Busisë” me nr. të prok: “616-19-9179-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën e Busisë” me nr. të prok: “616-19-9179-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues NNP “WENDA”-Vushtrri, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues NNP "WENDA"-Vushtrri, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 13.03.2020 me nr. 178/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën e Busisë" me nr. të prok: "616-19-9179-5-2-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 2, 4, 7, 59, 60, 72 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, Neni 4 – Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, nenin 41 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.03.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 01.04.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim: Sa i përket pretendimit të OE ankues ku thuhet që OE i propozuar për dhënie të kontratës nuk ka vendosur çmimin për njësi në pozicionet 1.7 dhe 2.6 në pjesën e punëve të makinerisë në Përshkrimin e Çmimeve – paramasa dhe paralogaria, dhe se sqarimi i AK-së në vendimin e këtij të fundit ngarkuar në platformën e e-prokurimit me datë 10.03.2020 është në kundërshtim me LPP-së duke potencuar që çmimet njësi mungojnë dhe s'kanë se si korrigjohen kur nuk janë të vendosura paraprakisht nga operatori ekonomik, Eksperti Shqyrtues pas vlerësimit të dokumenteve të tenderit dhe shkresave të dërguara, gjen pretendimin si pjesërisht të bazuar. Arsyetimi i një konstatimi të tillë është si në vijim: Sipas RRUOPP, konkretisht nenit 41 ku flitet për Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahësimin e Tenderëve, gjegjësisht paragrafi 10, thuhet që "Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet. Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmimin për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet si i tërhequr." Duke marrë parasysh që OE i rekomanduar për kontratë në pozicionet e lartpërmendura nuk ka shënuar çmimin me TVSH në paramasën e caktuar nga AK, një konstatim i pretendimit ankimor bazohet parimisht në këtë dispozitë ligjore. Arsyetimi i Autoritetit

Kontraktues pas Kërkesës për Rishqyrtim nga OE ankues duke dekompozuar llogaritjen e pozicioneve 1.7 dhe 2.6 është dashur të specifikohet në paramasën e Përshkrimit të Çmimeve, ku një llogaritje e pozicioneve të lartpërmendura është dashur të bëhet me “automatizëm” konform plotësimit të çmimeve të pozicioneve relevante të tjera. Sa i përket pretendimit të OE ankues ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë me rastin e ofertimit – dorëzimit të dokumenteve në platformën elektronike e-prokurim, nuk ka dorëzuar dokumente në pajtim me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, konkretisht pikën 9.1 & 9.2 pika 2 e FDT-së, pasi që nuk ka dorëzuar vendimin apo një shkresë se cili nga inxhinierët e ofruar do të jetë udhëheqës i punishtes ose menaxher i projektit, një pretendim i tillë është i pabazuar. Në kontratën ndërmjet punëdhënësit (OE i rekomanduar për kontratë) dhe punonjësit (Menaxheri i caktuar i Punishtes) përmendet fushëveprimi i “menaxhimit të përditshëm i vendit të punishtes, përfshimi monitorimi i fuqisë punëtore dhe punën e të nën kontraktuarve”, gjë që merret si klauzolë për kërkesën e lartpërmendur. Për më tepër, Kërkesat mbi Mundësitë Teknike dhe/ose Profesionale – pika 9.1 & 9.2 nuk është e specifikuar mjaftueshëm nëse një vendim i caktimit të Menaxherit të Punishtes duhet dorëzuar decitivisht si vendim i ndarë, pasi që tek dëshmitë dokumentare përmendet “Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.”. Si të tillë, sa i përket këtij pretendimi ankimor, konform dispozitave ligjore të LPP-së, konkretisht nenit 56, paragrafi i 4-të “Tenderuesi në procedurat e hapura ose kandidati në procedurat e kufizuara dhe procedurat e negociuara pas publikimit të kontratës nuk do të shkualifikohet, përjashtohet ose eliminohet nga këto procedura në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është përcaktuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.”.

Sa i përket pretendimit ankimor se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta, ku edhe pas sqarimeve shtesë të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues nuk janë arsyetuar, argumente këto duke mos u mbështetur në dispozitën ligjore, gjegjësisht neni 4, pika 4.2 Procedura e Shqyrtimit (interpartes) – B57 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, e cila potencon: “Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja, Eksperti pas shqyrtimit të lëndës, përgjigjeve të OE të rekomanduar për kontratë, shkresave të lëndës, gjen pretendimin si të bazuar. Arsyetimi është si në vijim: · Konform Rregullores për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, Autoriteti Kontraktues me të drejtë ka kërkuar informata shtesë përçmimin e ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë. Kërkesa drejtuar këtij të fundit për qartësim të çmimeve është bërë vetëm për çmim total, dhe jo për pjesë relevante, apo pozicione të caktuara. Duke marrë parasysh që neni 4, gjegjësisht paragrafi 2 i Rregullores për çmime jo normalisht të ulëta thërret për zbërthim të detajuar, Autoriteti Kontraktues nuk ka

zbatuar në përpikëri kërkesën për informata shtesë. · Arsyetimi i OE të rekomanduar për kontratë pas Kërkesës për Sqarim të Tenderëve dërguar nga Autoriteti Kontraktues është i përgjithshëm dhe nuk ofron dëshmi relevante sa i përket arsyetimit të ofertës nga ky Operator. Argumentet sikurse “gjatë kalkulimit të çmimeve për këtë projekt kemi pasur parasysh sigurimin e pagave si dhe reduktimin e shpenzimeve tjera sikurse transporti, ushqimi, pasi që jemi biznes familjar” nuk arsyetojnë çmimet e pozicioneve të ofertuara, duke marrë parasysh që këto të fundit duhet të jenë në një linjë me çmimet e tregut. · Rritja e sigurisë së ekzekutimit të tenderit nga 10% në 20% caktuar për OE e rekomanduar për kontratë nga AK, propozuar nga vet OE i rekomanduar për kontratë, është argument i pamjaftueshëm pasi që një manovrim i tillë nuk krijon një trajtshmëri në ofertimin e çmimeve për pozicione, duke krijuar hapësirë kështu për shkeljen e çmimeve të tregut. Bazimi i një vendimi të tillë konform nenit 30, paragrafit 4 të RRUOPP, është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik lidhur me çmimet jo normalisht të ulëta, konkretisht nenin 61 dhe me Rregulloren për çmime jo normalisht të ulëta. Në rast aplikimi, një logjikë e tillë do të përjashtonte trajtimin e tenderëve me çmim jo normalisht të ulët. Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e OE ankues si pjesërisht të bazuar dhe duke marrë parasysh faktet dhe konstatimet e mësipërme dhe sugjeron që vendimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën e Busisë” me numër të prokurimit “616-19-9179-5-2-1”, iniciuar nga AK – KK Prishtinë, të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 02.04.2020 , me anë të shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues, mirëpo i njëjti nuk ka kthyer përgjigje.

Operatori Ekonomik, me datë: 03.04.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 16.04.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa

e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues NNP “WENDA”-Vushtrri se OE i propozuar për dhënie të kontratës nuk ka vendosur çmimin për njësi në pozicionet 1.7 dhe 2.6 në pjesën e punëve të makinerisë në përshkrimin e çmimeve – para masa dhe para llogaria, dhe se sqarimi i AK-së në vendimin e këtij të fundit ngarkuar në platformën e e-prokurimit me datë 10.03.2020 është në kundërshtim me LPP, duke potencuar që çmimet njësi mungojnë dhe s’kanë se si korrigjohen kur nuk janë të vendosura paraprakisht nga operatori ekonomik. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim është pjesërisht i bazuar. Sipas RRUOPP-së, konkretisht nenit 41 ku flitet për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, gjegjësisht par.10 “Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet. Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmimin për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet si i tërhequr.” Duke marrë parasysh që OE i rekomanduar për kontratë në pozicionet e lartpërmendura nuk ka shënuar çmimin me TVSH në para masën e caktuar nga AK, një konstatim i pretendimit ankimor bazohet në këtë dispozitë ligjore. Arsyetimi i autoritetit kontraktues pas kërkesës për rishqyrtim nga OE ankues duke dekompozuar llogaritjen e pozicioneve 1.7 dhe 2.6 është dashur të specifikohet në para masën e përshkrimit të çmimeve, ku një llogaritje e pozicioneve të lartpërmendura është dashur të bëhet me “automatizëm” konform plotësimit të çmimeve të pozicioneve relevante të tjera.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues NNP “WENDA”-Vushtrri se OE i rekomanduar për kontratë me rastin e ofertimit – dorëzimit të dokumenteve në platformën elektronike e-prokurim, nuk ka dorëzuar dokumente në pajtim me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, konkretisht pikën 9.1 & 9.2 pika 2 e FDT-së, pasi që nuk ka dorëzuar vendimin apo një shkresë se cili nga inxhinierët e ofruar do të jetë udhëheqës i punishtes ose menaxher i projektit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor është i pa bazuar sepse në kontratën ndërmjet punëdhënësit (OE i rekomanduar për kontratë) dhe punonjësit (Menaxheri i caktuar i Punishtes) përmendet fushëveprimi i “menaxhimit të përditshëm i vendit të punishtes, përfshimi monitorimi i fuqisë punëtore dhe punën e të nën kontraktuarve”, gjë që merret si klauzolë për kërkesën e lartpërmendur. Për më tepër, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – pika 9.1 & 9.2 nuk është e specifikuar mjaftueshëm nëse një vendim i caktimit të menaxherit të Punishtes duhet dorëzuar decidivisht si vendim i ndarë, pasi që tek dëshmitë dokumentare përmendet “Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.”. Si të tillë, sa i përket këtij pretendimi ankimor, konform dispozitave ligjore të LPP-së, konkretisht nenit 56, paragrafi i 4-të “Tenderuesi në procedurat e hapura ose kandidati në procedurat e kufizuara dhe procedurat e negociuara pas publikimit të kontratës nuk do të shkualifikohet, përjashtohet ose eliminohet nga këto

procedura në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është përcaktuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.”.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues NNP “WENDA”-Vushtrri se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta, ku edhe pas sqarimeve shtesë të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues nuk janë arsyetuar, argumente këto duke mos u mbështetur në dispozitën ligjore, gjegjësisht neni 4, pika 4.2 Procedura e Shqyrtimit (interpartes) – B57 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, e cila potencon: “Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa drejtuar OE të rekomanduar për kontratë për qartësim të çmimeve është bërë vetëm për çmim total, dhe jo për pjesë relevante apo pozicione të caktuara. Duke marrë parasysh që neni 4, gjegjësisht paragrafi 2 i Rregullores për çmime jo normalisht të ulëta thërret për zbërthim të detajuar, Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar në përpikëri kërkesën për informata shtesë. Arsyetimi i OE të rekomanduar për kontratë pas kërkesës për sqarim të tenderëve dërguar nga Autoriteti Kontraktues është i përgjithshëm dhe nuk ofron dëshmi relevante sa i përket arsyetimit të ofertës nga ky OE. Argumentet sikurse “gjatë kalkulimit të çmimeve për këtë projekt kemi pasur parasysh sigurimin e pagave si dhe reduktimin e shpenzimeve tjera sikurse transporti, ushqimi, pasi që jemi biznes familjar” nuk arsyetojnë çmimet e pozicioneve të ofertuara, duke marrë parasysh që këto të fundit duhet të jenë në një linjë me çmimet e tregut. Rritja e sigurisë së ekzekutimit të tenderit nga 10% në 20% caktuar për OE e rekomanduar për kontratë nga AK, propozuar nga vet OE i rekomanduar për kontratë, është argument i pamjaftueshëm pasi që një manovrim i tillë nuk krijon një trajtshmëri në ofertimin e çmimeve për pozicione, duke krijuar hapësirë kështu për shkeljen e çmimeve të tregut. Bazimi i një vendimi të tillë konform nenit 30, paragrafit 4 të RRUOPP, është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik lidhur me çmimet jo normalisht të ulëta, konkretisht nenin 61 dhe me Rregulloren për çmime jo normalisht të ulëta.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe në sqarimet e ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së. Andaj, obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave të kërkoj sqarime të detajuara konform “Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët”, me qëllim të sqarimit të ekonomisë së procesit të prodhimitarisë, zgjidhjet teknike dhe kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin. Po ashtu, AK të shqyrtoj dhe sqaroj nëse OE i rekomanduar për kontratë ka dhënë çmimet për

njësi në pozicionet 1.7 dhe 2.6 të dosjes së tenderit. Po ashtu, paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Kuvendi Komunal Prishtinë
- 1x1 OE - NNP "WENDA"-Vushtrri
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.